REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
MINISTRI

Nr. 8797/1 Prot. Tiranë, më 24.11.2026

URDHËR

NR. 551, DATË 24.11.2026

PËR

MIRATIMIN E OFRIMIT EDHE NË GJUHËN ANGLEZE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "NAVIGACION", NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 35,73 dhe 88, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e ofrimit edhe në gjuhën angleze, të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Navigacion", në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

2. Veprimtaria akademike në programin e studimit edhe në gjuhën angleze, fillon sipas legjislacionit në fuqi.

3. Institucioni i arsimit të lartë, të marrë masa që programi i studimit t'i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Institucioni i arsimit të lartë, të respektojë ngarkesën mësimore të personelit akademik, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Institucioni i arsimit të lartë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ministria e Arsimit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin në Ministrinë e Arsimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI